



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __.__.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shpenzime per aktivitete social-kulturore dhe sportive te vitit"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Instrumenta muzikorë, mallra sportive, lojëra, lodra, produkte artizanale, materiale arti
dhe aksesorë – 37; Trofe-39298700-4; Sherbim katering – 55520000-1**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 924 750 (Dy milion e nentëqind e njezet e kater mije e
shtateqind e pesedhjetë) leke pa TVSH.**

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST). Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të ngjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në bazë të mesatares së ofertave, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. **(Dokumentuar nga KLLFLST me Procesverbal nr. 631/1 prot datë 06.02.2025.**

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar

procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Pika 1a Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Pika 1.b Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjësinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, perkatesisht **1 169 900 leke pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji”.*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 10 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shterben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës perkatesisht: **584 950 leke pa TVSH.**

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve të deklaruara në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 55 pika 4/b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër levrimin e shërbimeve sipas grafikut të levrimit të shërbimeve bashkëngjitur preventivit shtojca 7 e DST-së.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar deklarata për përmbushjen me sukses të kontratave.

2.5 Referuar pikës 1 të nenit 26, të VKM nr.285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari

dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor **nr. 29 date 10.02.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”** me fond limit prej: **2 924 750 (Dy milion e nentëqind e njetzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH**, lloji i procedurës: **E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdher të Titullarit për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 4 pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit. - Bashkëlidhur DST Në SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, nëpërputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo reference duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet oseshërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas nenit 36 pika 3 e LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim Sp.teknike: Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr. **631 prot datë 27.01.2025**, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për shërbimet që do të realizoj. Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST, dorëzuar dokumentacioni teknik si **Procesverbali i Komisionit nr. 631 prot datë 06.02.2025** si dhe **Preventiv nr. 631/2 prot date 06.02.2025** dhe **specifikimet teknike** të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.

Preventiv

Objekti: Shpenzime për aktivitetin social-kulturore dhe sportive të vitit

7 -8 Marsi- Dita e Verës

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Banket	persona	150
1	Cirk për fëmijë	persona	2
2	Buqeta lulesh	copë	53

21 Mars "Dita Botërore e poezisë"

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
----	----------	--------	-------

1	Poet / Botues	persona	2
2	Kokteil	persona	97

Dita Botërore e librit për fëmijë

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Postera	copë	2
2	Libra për fëmijë	persona	30

Festivali i Komunitetit Rom

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Simbole per grupet pjesemarrese	cope	11
2	Certifikate pjesemarrese per grupet artistike	cope	11

Të Njohim Qytetin

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Transport	dite	10
2	Kafe	cope	150
3	Uje	cope	150

Dita Botërore e librit për të rritur

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Poster beze i madh	copë	1
2	Shkrimtarë/ lektor	persona	1
3	Kokteil	persona	35

Promovimi i librave të rinj

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Postera	copë	4
2	Kokteil	persona	300

Dita e Muzeve

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Kanavac	copë	50
2	Banderol	copë	1
3	Bojra	Pako	10
4	Fletëpalosje	cope	300

Festa e serave të gjelbërta

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Medalje +kupë	copë	2
2	Këngëtar	persona	1
4	Foni+ndricim	copë	1

1 Qershori

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Animator	persona	2
2	Dekor festues për fëmijët	copë	1

24

Korriku

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Këngëtar	persona	3
2	Humorist	persona	1
3	Skulpturë Vajza Myzeqare	copë	30
4	Medalje Qytetar Nderi	persona	10
5	Skene+foni+ndricim	copë	1
6	Certifikata me kapak	copë	20
7	Kupa 24 Korriku material inoks	copë	1
8	Medalje për fituesit e aktiviteteve	copë	15
9	Vlersim për fituesit sporti	persona	15
10	Albitra	persona	3
11	Banket	persona	100

Roskoveci Feston

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Foni+Ndricim	Copë	1
1	Këngëtar	persona	2

"Festa Ullirit"

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Skulpturë Vajza Myzeqare	copë	32
2	Uje natyral	copë	80
3	Vlersim për fituesit të vaj ullirit	copë	2
4	Degustues vaj ulliri	persona	2

5	Këngëtar	persona	1
6	Banket	persona	100
7	Shpërblim për fituesit (sporti)	persona	3

"Njeriu I Vitit"

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Banket	persona	74
2	Shpërblim për fituesit Volejboll	persona	21
3	Këngëtar	persona	2
4	Medalie "Njeriu I Vitit"	copë	13
5	Komisionerët	persona	10

Afatet e lëvrimit: Fillon nga data e lidhjes së kontratës dhe mbaron deri më **31.12.2025**.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: